

V E N D I M
Nr. 24, datë 4.1.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRESA E VENDIME TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE

Në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.7383, datë 8.5.1990 "Për gjykatat shoqërore", Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.5, datë 2.6.1962 "Për ndërtimin dhe vënien në përdorim të barkave sportive", neni 6 ndryshohet si vijon:

"Ndërtimi dhe vënia në përdorim e barkave sportive në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese, kur shkeljet nuk formojnë vepër penale, përbën kundërvajtje administrative deh dënohen me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 200 lekë nga përgjegjësi i seksionit të ekonomisë komunale të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Për konstatimin e kundërvajtjeve administrative kanë të drejtë të mbajnë procesverbal, përveç punonjësve të ngarkuar me ligj, edhe punonjësit e tjerë të caktuar nga drejtuesi i ndërmarrjes që administron plazhin.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë".

2. Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.3, datë 25.1.1978 "Për vulat zyrtare dhe aparatet shumëzuese për botim", bëhen këto ndryshime:

- Në nenin 15, paragrafi i dytë ndryshohet dhe shtohet paragrafi i tretë si vijon:

"Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 3, 5, 7, 8, 10, 11 dhe 12 të kësaj urdhërese, kur nuk formon vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 300 lekë nga shefi i policisë së rrethit.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te kryetari i degës së punëve të brendshme të rrethit, akti i të cilit është i formës së prerë".

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.363, datë 15.9.1964 "Për miratimin e rregullores "Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve e kanalizimeve elektrotelefoniqe të qyteteve"", neni 22 ndryshohet si vijon:

"Dëmtimet dhe shkatërrimet që i bëhen rrugëve e trotuareve ose rrjetit nëntokësor etj., kur shkeljet nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative që gjykohen nga organet e caktuara në dispozitat e Kodit Rrugor dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 129, datë 6.4.1985 "Për mbrojtjen e rrugëve dhe qarkullimin rrugor, dhe sipas procedurës së parashikuar në këto akte".

4. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.36, datë 3.5.1978 "Për miratimin e rregullores "Për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pendëve për mbrojtjen nga përmytjet"" shtohet neni 15 me këtë përmbajtje:

, "Kalimi i automjeteve, i mekanizmave të ndryshëm, i qerreve dhe i bagëtive mbi pendë jashtë vendeve të cfaktuara , si dhe çdo shkelje tjetër që u shkakton dëm pendëve, kur nuk përbën vepër penale, dënohet për kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 500 lekë nga drejtori i drejtorisë së ujrave dhe sistemeve në rreth.

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit ose e njoftimit të tij, te përgjegjësi i seksionit të bujqësisë të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit a të rajonit, akti i të cilit është i formës së prerë."

5. Urdhëresa e Këshillit të Ministrave nr.11, datë 28.11.1961 "Për ndalimin e ngarkimit të

gruas", dhe neni 15 i vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63, datë 27.9.1978 "Për administrimin e ujësjellësit në qytete dhe në fshatra" shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI